



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKAKOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijeto / Predato Received / Delivery	12.09	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMST/OK	3185/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.405/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.405/2023 të datës 23.02.2023, të parashtruar nga ankuesi "Avdi Kelmendi" Hy-1 K-2 Nr.3 Komuna Lipjanit, kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.405/2023 të datës 23.02.2023, të parashtruar nga ankuesi

II.Pala ankuese Udhëzohet në Gjykatën Kompetente të ushtroj mjetet juridike për realizimin e së drejtës së tij.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 23.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit të datës 08.02.2023, lidhur me kërkesën për pjesën e humbur të pagës në mënyrë retroaktive sa ka qenë i punësuar në pozitën "Zyrtar për Pronën e Paluajtshme nga koeficienti gjashtë (6) në shtatë (7) në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe për pozitën "Inspektor i Tregut nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8) .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, komfor dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.02.2023 ankesën e ankuesit e ka dërguar



për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli më datë 09.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokollit 2010/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit të datës 08.02.2023; Kërkesën e ankuesit me numër 1-120/04-5139 drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit të datës 30.01.2023; Shkresa e Ministrisë së Administratës Publike e datës 20.11.2014; Letërnjoftim i A.H.; Akt Emërim i A.H. i datës 01.05.2019; Akt Emërim i A.H. i datës 01.05.2018; Vërtetim me Nr. 01-181/01-32618 i datës 23.06.2022; Vendim për transferim të përkohshëm në vend tjetër të punës me Nr. 1-112-59336 i datës 21.09.2018; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.02.2023; E-mail nga R.H. për C.Z. i datës 09.03.2023 i protokolluar me numër 2591/2023 me datë 13.03.2023; Përgjigje në ankesë e datës 09.03.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 11.08.2010; Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me Nr.1-118-63374 i datës 30.12.2020; Njoftim me numër protokollit 1-118-63176 i datës 29.12.2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar provat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën A.nr.405/2023 të datës 23.02.2023, të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi e ka njoftuar përmes shkresës me numër protokollit 1-118-63176 të datës 29.12.2020 Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit lidhur me Dorëheqjen e tij nga pozita "Inspektor i Tregut" në Drejtoratin e Inspektoratit. Ndërsa Kryetari i Komunës së Lipjanit ka nxjerr Vendim me Nr. 1-118-63374 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit me datë 30.12.2020.

Mbi bazë të këtij Vendimi me Nr. 1-118-63374 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 30.12.2020, Kolegji ka konstatuar se i njëjti e ka humbur statusin e nëpunësit civil, si dhe bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publik Ligjit Nr. 06/L - 114 ku përcaktohet në nenin 2 paragrafin 3 të këtij ligji: *3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.*


Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.405/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.405/2023

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

Ankuesit

Kryetarit të Komunës së Lipjanit;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit; dhe

Arkivit të KPMSHCK- së;